

RREGULLORJA PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024

Për nxënësin : _____

Institucioni arsimor parashkollor “Eurolingua” është një institucion privat i cili ofron arsimin parashkollor për moshat 3-6 vjeçare.

Ky institucion është i hapur për të gjithë fëmijët e kësaj moshe, pa dallim përkatësie gjinore, fetare apo rracore.

Kopshti do të punojë në bazë të programeve të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.

Oraret

- Prindërit janë të lutur të sjellin fëmijët në oraret e caktuara për të mos prishur mbarëvajtjen e mësimin.
- Për çdo mungesë apo vonesë, prindërit duhet të lajmërojnë në kohë drejtuesen e kopshtit.
- Për një funksionim sa më të mirë të procesit mësimor, prindërit janë të ndaluar të futen në ambientet mësimore.

Institucioni

- “Kopshti është i detyruar të sigurojë të gjithë bazën materiale për mbarëvajtjen sa më të mirë të procesit mësimor.
- Kopshti siguron kushtet optimale të godinës së tij ku do të ushtrohet aktiviteti.
- Për çdo rast aksidenti, sëmundje apo dëmtime të fëmijëve kopshti njofton menjëherë prindërit.
- Kopshti i jep çdo prindëri në prag të fillimit të vitit shkollor listën e sendeve personale që çdo fëmijë duhet të sjellë me vete.
- Kopshti mban në përdorim një kuti të ndihmës së shpejtë në raste dëmtimesh të ndryshme. Kjo në marrëveshje paraprake me prindërit.
- Kopshti do të jetë i hapur sipas kalendarit shkollor të miratuar nga MASH.
- Gjatë pushimeve të verës kopshti funksionon me një program të veçantë ku pjesën më të madhe të orarit e zenë lojërat dhe aktivitetet e lira të fëmijëve.
- Kopshti afishon/ dërgon me e-mail çdo të hënë menunë e javës.
- Kopshti është i hapur të mirëpresë çdo mendim që është në të mirë të procesit të rritjes dhe edukimit të fëmijëve.
- Pas datës 1 Shtator 2023 kopshti nuk merr përsipër mëngjesin për fëmijët që vijnë në kopsht **pas orës 9.00** (kjo bëhet për të siguruar mbarëvajtjen e procesit mësimor).

Pagesat

- Pas nënshkrimit të kontratës prindërit kryejnë pagesat pranë degës së bankës të caktuar nga institucioni ynë në **datat 1-10 të çdo muaji:**
- **BKT (Banka Kombëtare Tregtare) Nr. Llog. 401304173CLPRCLALLT3**
Iban: AL8920531775304173CLPRCLALLT
- *Pavarësisht mungesave që mund të bëjë fëmija, prindi është i detyruar të paguajë gjithë muajin.*
- *Në rast se fëmija mungon gjatë gjithë muajit prindi është i detyruar të paguajë një të dytën e shumës (50%).*
- *Në degët e bankave mund të bëhen pagesa për më shumë se një muaj.*
- **Tarifa e regjistrimit 10 000All (paguhet vetëm në momentin e regjistrimit për herë të parë në institucionin tonë, tarifë kjo e pakthyeshme në rast ç' regjistrimi nga kopshti).**
- **Tarifa e kancelarisë 5 000All (çdo fillim viti)**
- **Tarifa e muajit 25 000 All (përfshihet dhe ushqimi)**
- **Tarifa e transportit 7 000 All**

Shërbimet që do të marrë fëmija brenda pagesës së muajit

janë:

Proçesi mësimor, vaktet (mëngjesi, dreka, zemra) dhe fjetja.

Me transport: Po Jo

Totali për t'u pagur: _____ (_____) lekë.

Nënshkrimi i prindit

Administratori

Bledar LAMÇE

(Ky dokument firmoset në dy kopje, një e mban drejtorja, një e merr prindi.)